

Sektori i veprave penale të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 68 të Rregullores gjyqësore ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 66/2013 nga 09.05.2013), si dhe nenet 31, 34, 37, 38, 39 dhe 41 të Rregullores për punën e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 13/98 dhe 21/09), në seancën e mbajtur me datë 27.11.2019, solli:

M E N D I M J U R I D I K

Gjykatësi i cili ka marrë pjesë si anëtarë i Këshillit penal në procedurë për ankesë kundër aktvendimit të këshillit për vlerësimin e aktakuzës në kuptim të nenit 328 paragrafi 2 të Ligjit për procedurë penale, kur kundërshtimi i parashtruar kundër aktakuzës është hedhur poshtë si jo me kohë, ose si i palejuar, mund të jetë anëtarë i këshillit dhe në mënyrë meritore të vendos për ankesën e deklaruar në gjykatën e shkallës së dytë kundër aktgjykimit për çështjen kryesore.

A r s y e t i m

Sektori i veprave penale të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, mbajti seanca me datë 25.09.2019, me datë 02.10.2019 dhe me datë 07.11.2019, në të cilat shqyrtoi për kërkesën e parashtruar të Gjykatës së apelit Shkup, për sjelljen e mendimit juridik për zbatimin e bazave të përjashtimit të gjykatësit sipas nenit 33 paragrafi 1 pika 4 dhe 5 të Ligjit për procedurë penale, sa i përket pyetjes: Vallë gjykatësi mund të merr pjesë në procedurë për ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së parë, nëse paraprakisht ka marrë pjesë si anëtarë i Këshillit penal për vlerësimin e aktakuzës në kuptim të nenit 328 të LPP, kur kundërshtimi i parashtruar kundër aktakuzës është hedhur poshtë si jo me kohë, ose si i palejuar, ndërsa vendimi është konfirmuar nga ana e gjykatës së shkallës së dytë?

Kjo gjykatë gjatë shqyrtimit për këtë çështje juridike, i ka pasur parasysh dhe i ka vlerësuar aktgjykimet dhe qëndrimet e shprehura juridike në aktgjykimet: Kzz.nr. 41/16 nga 19.06.2017, Vkzh2.nr. 13/19 nga 23.05.2019 dhe Kvp.nr. 204/2008 nga 23.09.2008.

Po ashtu, gjatë procedimit Sektori i veprave penale ka pasur parasysh dhe ka vlerësuar praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg. Në fakt, GJEDNJ ka marrë qëndrim se nuk mund të ketë problem me mungesën e paanshmërisë kur ndonjë gjykatës ka marrë pjesë në marrjen e vendimeve formale dhe procedurale në fazat e tjera të procedurës, megjithatë, probleme me paanshmërinë mund të ndodhin vetëm nëse në fazat tjera të procedurës ndonjë gjykatës veç më ka shprehur mendim për fajin e të akuzuarit (Gomez de Lijano dhe Botelja kundër Spanjës (Gomez de Liano u Botella v. Spain), nr. 21369, § § 67- 72, 22 korrik 2008).

Në rastin konkret, gjykatësi nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin meritor dhe vlerësimin e aktakuzës të gjykatës së shkallës parë, por është lëshuar vetëm në shqyrtimin e lejueshmërisë së kundërshtimit të parashtruar kundër aktakuzës, që përfaqëson veprim që ka vetëm karakter juridiko – procesor. Aktvendimi me të cilin hedhet poshtë kundërshtimi si jo me kohë, ose si i palejuar paraqet vendim formal, procesor me të cilin nuk merr vendim meritor për çështjen kryesore, ndërsa gjykatësi që ka proceduar si anëtarë i Këshillit penal në procedurë për ankesë kundër aktvendimit të këshillit për vlerësimin e aktakuzës nuk ka treguar mendimin e tij sa i përket përgjegjësisë penale të akuzuarit, as për fajin dhe paramendimin e të akuzuarit për ngjarjen konkrete juridiko – penale. Në këtë rast, gjykatësi i shqyrton veçanërisht aspektet juridiko – procesor të lejueshmërisë së aktakuzës, pa ndërhyrë në vlerësimin e tij.

Kjo situatë juridike, dallohet nga situata kur gjykatësi merr pjesë në vendimmarrje meritorë dhe në vlerësimin e aktakuzës, ashtu që formon edhe mendim të vetin në drejtim të refuzimit të tij, ose përmirësimit.

Për këto arsye, Sektori i veprave penale i kësaj gjykate vlerëson se gjykatësi që ka marrë pjesë si anëtarë i Këshillit penal në procedurë për ankesë kundër aktvendimit të këshillit për vlerësimin e aktakuzës në kuptim të nenit 328 paragrafi 2 të LPP, kur kundërshtimi i parashtruar kundër aktakuzës është hedhur poshtë si jo me kohë ose si i palejuar, mund të jetë anëtarë i këshillit dhe të merr vendim meritor për ankesën e deklaruar në gjykatën e shkallës së dytë kundër aktgjykimit të shkallës së parë për çështjen kryesore, duke qenë se gjykatësi paraprakisht ka pasur mundësi të vendos posaçërisht për çështje të natyrës juridiko – procesor, pa formuar qëndrim dhe mendim sa i përket përgjegjësisë penale të akuzuarit për ngjarjen juridiko – penale.

Nga këtu, në këtë rast për këtë çështje juridike nuk ekzistojnë kushte për përjashtimin e gjykatësit, sipas nenit 33 paragrafi 1 pika 4 dhe 5 të LPP, respektivisht nuk ekziston asnjë pengesë nga aspekti i sigurimit të garancive dhe standardeve për paanshmërinë dhe gjykim të drejtë të inkorporuar në dispozitat përkatëse të LPP. Edhe më tepër, as nga aspekti i nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk do të mundej të konstatohen çfarëdo lloj pengesash për procedimin dhe vendosjen e gjykatësit të gjykatës së shkallës së dytë, i cili paraprakisht ka marrë pjesë si anëtarë i Këshillit penal në procedurë për ankesë kundër aktvendimit të këshillit për vlerësim të aktakuzës në kuptim të nenit 328 paragrafi 2 të LPP, kur kundërshtimi i parashtruar kundër aktakuzës është hedhur poshtë si jo me kohë, ose si i palejuar.

Duke marrë parasysh të ekspozuarën më lartë, ky Mendim Juridik është në drejtim të vendosjes së çështjeve juridike që kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e nenit 33 paragrafi 1 pika 4 dhe 5 të LPP dhe rivendosjen e praktikës së sinkronizuar gjyqësore në situata të njëjta apo të ngjashme në gjykatat në të ardhmen.

**SEKTORI I VEPRAVE PENALE
TË GJYKATËS SUPREME TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**